

VENDIM
Nr. 85, datë 9.5.2024

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 62, DATË 11.4.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘KESH’ SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK I DIGËS QYRSAQ, HEC ‘VAU I DEJËS’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5.143 mwp”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 198/14 prot., datë 8.5.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.4.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘KESH’ sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik i digës Qyrfaq, HEC ‘Vau i Dejës’, me kapacitet të instaluar 5.143 mwp”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 62, datë 11.4.2022, me të cilën është licencuar shoqëria “KESH” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik i digës Qyrfaq, HEC “Vau i Dejës”, me kapacitet të instaluar 5143 kwp, për një afat 25-vjeçar, ka kërkuar nga shoqëria “KESH” sh.a. të depozitojë në ERE, brenda afateve të përcaktuara në vendim, si më poshtë vijon:

- Shoqëria “KESH” sh.a. duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjykatës dhe prokurorisë për administratorin e saj;

- Shoqëria “KESH” sh.a. duhet të bëjë me dije në ERE mbi vendimin e gjykatës; në lidhje me ankimimin e detyrimeve (gjoba) në tatimin mbi fitimin dhe dënime pa tatim, për të cilat është në proces gjyqësor, brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit të gjykatës;

- Shoqëria “KESH” sh.a. duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të vitit 2020 të audituara.

- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë “KESH” sh.a., me shkresat (nr. 111/7 prot., datë 6.6.2022, nr. 308 prot., datë 19.1.2023, nr. 1796/7 prot., datë 19.9.2023, nr. 198/9 prot., datë 13.3.2024), në përgjigje të tyre, shoqëria, nëpërmjet shkresave (nr. 37/4 prot., datë 31.2.2023, nr. 1796/1 prot., datë 18.8.2023, nr. 198/10 prot., datë 21.3.2024 dhe nr. 198/12 prot., datë 4.4.2024) ka depozituar informacionin e dokumentacionin për plotësimin e kushteve të vendimit të sipërcituar.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2, që ka të bëjë me depozitimin në ERE të vërtetimit të gjykatës dhe prokurorisë për administratorin e saj, shoqëria ka depozituar vërtetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Me depozitimin e tyre shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.4.2022, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3, që ka të bëjë me vënien në dije të ERE-s mbi vendimin e gjykatës, në lidhje me ankimimin e detyrimeve (gjoba) në tatimin mbi fitimin dhe dënime pa tatim, për të cilat është në proces gjyqësor, shoqëria ka bërë me dije se nuk është më në një proces gjyqësor, në lidhje me detyrime (gjoba) për tatim fitimin dhe dënime pa tatim, në vërtetimin për detyrimet në kohë reale të depozituar rezulton se shoqëria nuk ka detyrime dhe gjoba, si e tillë rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.4.2022, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, që ka të bëjë me depozitimin në ERE të pasqyrave financiare të vitit 2020 të audituara, shoqëria, me shkresat e protokolluar në ERE (nr. 1796/1 prot., datë 18.8.2023, nr. 198/12 prot., datë 4.4.2024), ka depozituar pasqyrat financiare për vitin 2020 të audituara, gjithashtu, vlen të theksojmë se shoqëria është pajisur me certifikatën e garancisë së origjinës për sasitë e energjisë të prodhuar për vitin 2022 dhe vitin 2023. Si e tillë, pjesa e mbështetjes financiare, në kuadër të kërkesave të këtij neni rezulton e plotësuar. Me depozitimin e tyre shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.4.2022, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2, 3 dhe 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.4.2022, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “KESH” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti